

## **THIRRJE PËR OFERTA**

**205/SiV/2021 - Furnizimi me pajisje TI për projektin "Iniciativa për Integrim në Kosovë 2020 - KOSINT" – financuar nga Zyra e Inicativave Rome (RIO) në kuadër të Fondacionit për Shoqëri të Hapur (FShH) dhe zbatuar nga Syri i Vizionit (SiV)**  
në partneritet me tre organizata të shoqërisë civile.

### **Termet e referencës**

Dhjetor 2021

**Afati i fundit për ofertat:** 22 dhjetor 2021

### **Për Syri i Vizionit**

Syri i Vizionit (SiV) është regjistruar zyrtarisht si OJQ lokale në shtator të vitit 2001, por ka filluar të operojë në komunën e Pejës që nga viti 1999 si Organizatë e Bazuar në Komunitet (OBK).

Që prej fillimit, motoja e organizatës ishte "Mendo globalisht, vepra lokalisht", të cilës i qëndroi besnike. Misioni i organizatës është "zhvillimi i komunitetit të njerëzve, grupeve joformale, organizatave, rrjeteve, institucioneve dhe donatorëve përmes avokimit, shkëmbimit të informacionit dhe rritjes së ndërgjegjësimit" dhe SiV përmes veprimit të saj dëshmon se është një organizatë që realizon veprime lokale bazuar në praktikat më të mira.

### **Informata të përgjithshme**

Syri i Vizionit, në kuadër të programit KOSINT, të përfaqësuar nga organizatat partnere SiV, RADC, dhe VORaE, në partneritet me Roma Versitas Kosova tash e disa vite është duke u angazhuar në gjithëpërfshirjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në fushat shoqërore dhe ekonomike. Projekti është i mbështetur dhe financuar nga Zyra e Inicativave Rome (RIO) në kuadër të Fondacionit për Shoqëri të Hapur (FShH). Projekti gjithashtu ka disa komponenta si Romët për politike të re, e që ka për qëllim të përmirësojë qasjen për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në punësim, strehim dhe demokratizim (zgjedhje qendrore e lokale dhe regjistrimin e popullsisë) duke kontribuar kështu në ndikimin për përmbushjen e zotimeve përkatëse të bëra nga Qeveria e Kosovës, në formën e politikave të reformës sektoriale të cilat përqendrohen në punësim, strehim si dhe demokratizim e qytetari aktive.

“Syri i Vizionit” në pajtim me përshkrimin dhe nevojat e projektit, shpall këtë tender për blerjen e **50 kompjuterëve tablet** me përshkrimin e përgjithshëm të specifikimeve teknike si më poshtë:

- Pajisjet e kërkuara duhet të ndihmojnë stafin në kryerjen e punës së tyre të përditshme gjatë regjistrimit të popullsisë, si p.sh. përdorimi i aplikacioneve për shkrim, futja e të dhënave në bazat e të dhënave dhe qasje në internet.
- Memoria e brendshme duhet të jetë 8 GB (ose më e madhe). Duhet të ketë 1 GB Ram (ose më shumë) dhe ekrani duhet të jetë 8 inç (ose më i madh).
- Kompjuterët tablet duhet të punojnë pandërprerë dhe shpejt, edhe në rastet kur punojmë më shumë se në pesë dokumente në të njëjtën kohë.
- Data e lëshimit të pajisjes duhet të jetë pas vitit 2019
- Kompjuterët tablet duhet të kenë garanci minimale njëvjeçare

**Dokumentet e nevojshme:**

- Certifikata e biznesit dhe numri fiskal i biznesit
- Oferta përfshin: (specifikimin teknik dhe ofertën financiare pa TVSH)
- Koha e dorëzimit dhe periudha e garancisë

**Ofertat:**

Të gjitha ofertat duhet të dorëzohen në letër ose me email jo më vonë se më 24 dhjetor 2021 në zyrën e “Syri i Vizionit”, ose me email [info@syriivizionit.org](mailto:info@syriivizionit.org), Adresa: ISA DEMAJ, 14, 30000 Pejë, Kosovë.

(Vërejtje: Ju lutemi të dërgoni oferta vetëm për pajisje të reja).